


MBROJTËSI

Nr. 16 / 2025

www.kosovopolice.com



**MONOGRAFIA E POLICISË SË KOSOVËS,
HISTORI, IDENTITET DHE VIZION INSTITUCIONAL**

Editorial



Botimi i parë i monografisë zyrtare të Policisë së Kosovës, me rastin e shënimit të 26-vjetorit të themelimit të saj, përbën ngjarjen më të rëndësishme institucionale të këtij viti dhe një moment historik në konsolidimin e identitetit profesional të Policisë së Kosovës. Kjo monografi nuk është vetëm një dokument arkivor, por një vepër gjithëpërfshirëse, dokumentuese dhe analitike, që pasqyron rrugëtimin e një institucioni kyç të shtetit të Kosovës, nga rrethanat e jashtëzakonshme të pasluftës deri te standardet bashkëkohore të policimit demokratik.

Monografia shërben si arkiv i kujtesës institucionale dhe si reflektim akademik mbi ndërtimin e një policie moderne, shumëetnike dhe orientuar drejt shërbimit ndaj qytetarit. Ajo dokumenton fazat kyçe të zhvillimit të Policisë së Kosovës, themelimin e Shërbimit Policor të Kosovës më 6 shtator 1999 me mbështetjen e OSBE-së, tranzicionin gradual të kompetencave nga UNMIK-u, riemërtimin dhe konsolidimin pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, si dhe ndërtimin e strukturave profesionale dhe organizative që e karakterizojnë sot Policinë e Kosovës si institucion kushtetues dhe të besueshëm.

Një vlerë e veçantë e monografisë është trajtimi i policimit në bashkësi si filozofi pune dhe model i qëndrueshëm i ndërtimit të sigurisë përmes partneritetit me qytetarët. Po ashtu, monografia nderon sakrificën e zyrtarëve policorë të rënë në krye të detyrës dhe përkushtimin human të institucionit në periudha sfiduese, duke e vendosur dimensionin njerëzor në qendër të identitetit institucional. Si e tillë, kjo vepër përfaqëson një dokument referencial me rëndësi të veçantë për studiuesit, profesionistët e sigurisë dhe publikun e gjerë, duke dëshmuar se Policia e Kosovës ka evoluar paralelisht me shtetin e Kosovës.

Në këtë kontekst të konsolidimit institucional, viti që po lëmë pas u shënuar edhe nga arritje të jashtëzakonshme në fushën e sigurisë publike, të konfirmuara nga vlerësime të larta ndërkombëtare. Sipas Gallup Global Law and Order Index 2024–2025 dhe Gallup Global Safety Report 2025, Kosova renditet e treta në nivel global dhe e para në Evropë për ndjenjën e sigurisë së qytetarëve dhe besimin ndaj institucioneve të zbatimit të ligjit. Me 94 pikë nga 100 në Indeks të Ligjit dhe Rendit, Kosova pozicionohet përkrah vendeve më të sigurta në botë, duke lënë pas shtete me traditë të gjatë demokratike. Këto rezultate janë dëshmi e drejtpërdrejtë e punës profesionale, planifikimit strategjik dhe përkushtimit të Policisë së Kosovës në ndërtimin e rendit dhe ligjit.

Paralelisht, Global Organized Crime Index për vitet 2023–2025 e vlerëson Kosovën si vendin me nivelin më të ulët të kriminalitetit të organizuar në Ballkanin Perëndimor. Ky vlerësim, i bazuar në analiza të thella mbi tregjet kriminale, aktorët dhe kapacitetet institucionale të reagimit, konfirmon efikasitetin e Policisë së Kosovës në luftimin e krimit të organizuar dhe forcimin e sundimit të ligjit, përmes bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndërkombëtar.

Një dimension tjetër i rëndësishëm i sigurisë publike, ai i sigurisë në trafikun rrugor, shënoi përmirësime të dukshme. Raporti i Transport Community për vitin 2024 evidenton rënie të viktimave në aksidente fatale dhe pozicionimin e Kosovës më mirë se shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Këto rezultate janë reflektim i angazhimit të vazhdueshëm të Policisë së Kosovës përmes planeve operacionale, fushatave sensibilizuese dhe zbatimit rigoroz të ligjit në trafik.

Viti u karakterizua edhe nga thellimi i partneriteteve strategjike ndërkombëtare, veçanërisht bashkëpunimi Kosovë-SHBA. Ushtrimi i përbashkët i reagimit ndaj krizave, me pjesëmarrjen e rreth 800 zyrtarëve policorë dhe shërbimeve emergjente, dëshmoi gatishmërinë operacionale, profesionalizmin dhe ndërveprueshmërinë e Policisë së Kosovës. Ky bashkëpunim forcon kapacitetet e reagimit ndaj situatave komplekse dhe e pozicionon Policinë e Kosovës si partnere të besueshme në arkitekturën ndërkombëtare të sigurisë.

Në të njëjtën frymë, projekti “Njihuni me policinë e lagjes tuaj” përfaqëson zbatimin konkret të parimeve të policimit në bashkësi, duke e afruar Policinë e Kosovës me qytetarët dhe duke rritur besimin, bashkëpunimin dhe parandalimin e krimit në nivel lokal. Trajnimet profesionale, investimet në logjistikë dhe përkushtimi i zyrtarëve policorë dëshmojnë orientimin e vazhdueshëm të institucionit drejt shërbimit cilësor për qytetarët.

Në përmbyllje, ngjarjet dhe arritjet e këtij viti, të kurorëzuara me botimin e monografisë zyrtare, dëshmojnë se Policia e Kosovës sot është një institucion i konsoliduar, profesional dhe modern. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar ndaj misionit të saj themelor, mbrojtjes së jetës, rendit kushtetues dhe sigurisë së qytetarëve, në përputhje me standardet më të larta demokratike.

Baki Kelani
Kryeredaktor

Revista ‘Mbrojtësi’ - Revistë e Policisë së Kosovës

Botues: DIMP - Drejtoria për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun e PK-së - DPP - Prishtinë

Kryeredaktor: Baki Kelani, **Redaktor përgjegjës:** Daut Hoxha, **Dizajn - grafik:** Çajup Kajtazi, **It-Multimedia:** Arbër Muhadri, Arlind Sadiku

Redaksia: Luljeta Mehmeti Quigley, Bajram Krasniqi, Merita Canolli - Gashi, Arlinda Rexhepi - Gërzhaliu, Blerinë Ejupi-Tahiri

Lektor: Leonora Fejzullahu - Ruhani.

Telefonat kontaktues: 038 5080 1243, 038 5080 1237, mob: 044 506 308, 044 181 418

E-mail: zimp@kosovopolice.com, info@kosovopolice.com.

www.kosovopolice.com, facebook.com/KosovoPolice

MBROJTËSI


PËRMBAJTJA

FAQE 6

26 VJET NË SHËRBIM TË SIGURISË DHE QYTETARËVE

FAQE 8

MONOGRAFIA E POLICISË SË KOSOVËS, HISTORI, IDENTITET DHE VIZION INSTITUCIONAL



PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të disa shkrimeve të këtij botimi nuk paraqesin medeomos qëndrimet ose vështrimet zyrtare të PK-së

TAKOHEM KRERËT E DY INSTITUCIONEVE NGA KOSOVA DHE SHQIPËRIA, 4

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I PK-SË, KOLONEL GAZMEND HOXHA, PRITI NË TAKIM KOMANDANTIN E KFOR-IT, GJENERAL OZKAN ULUTAS, 4

DREJTORI HOXHA TAKOHET ME SHEFIN E MISIONIT TË EULEX-IT, Z. BARBANO, 4

AMBASADORI I BE-SË NË KOSOVË, Z. AIVO ORAV TAKOHET ME DREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË KOSOVËS, KOLONEL GAZMEND HOXHA, 5

DREJTORI I POLICISË SË KOSOVËS PRITI NË TAKIM ZYRTARËT E NJËSIVE SPECIALE-ELITE, 6

PARTNERITET I FORTË DHE MIQËSI E QËNDRUESHME NË MES TË POLICISË SË KOSOVËS DHE FBI-SË, 6

26 VJET NË SHËRBIM TË SIGURISË DHE QYTETARËVE, 6

DITA MEMORIALE - NDERIM PËR HERONJTË E POLICISË SË KOSOVËS, 8

USHTRIMI I PËRBASHKËT I REAGIMIT NDAJ KRIZAVE - PARTNERITET STRATEGJIK NË VEPRIM, 9

MAJORJA E POLICISË SË KOSOVËS DIPLOMON NË AKADEMINË KOMBËTARE TË FBI-SË, 10

KOSOVA, E PARA PËR SIGURI NË RAJON DHE TRETA NË NIVEL BOTËROR, 11-12

NJIHUNI ME POLICIN E LAGJES TUAJ, 13

INTERVISTË ME KOLONEL NESHAT FLUGAJN, 14-15

MISION I SHËNDETIT, DISIPLINËS DHE PËRFAQËSIMIT ME DINJITET, 16 -17

EKIPI I POLICISË SË KOSOVËS ARRIN NË FINALEN E GARËS NDËRKOMBËTARE NË JORDANI, 18

OPERACIONET, 19-21

MUZEU I POLICISË SË KOSOVËS SI OBJEKTIV I RËNDËSISHËM PËR RUAJTJEN DHE PROMOVIMIN E TRASHËGIMISË INSTITUCIONALE, 22

BISEDË ME PSIKOLOGUN, 23

'MBROJTËSI', ASET TRASHËGIMOR I POLICISË SË KOSOVËS, 24

SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS, NDERIMI I HERONJVE DHE FORCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR, 25

NËN DRITËN E KALTËR - TREGIME TË JETËS POLICORE, 26

ZYRTARI POLICOR QË SFIDON KUFIJTË, NË SHËRBIM DHE NË VRAPIM, 27

AKTIVITETE

Takohen krerët e dy institucioneve nga Kosova dhe Shqipëria



Me datën 01.10.2025 drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës kolonel Gazmend Hoxha, me bashkëpunëtorët e tij, priti në një takim zyrtar kryeprokurorin e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) z. Altin Dumani, nga Republika e Shqipërisë.

Drejtori Hoxha fillimisht i dëshiroi mirëseardhje z. Dumani dhe njëherit e njoftoi për punën, angazhimet profesionale të PK-së kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe për bashkëpunimin që PK-ja ka me autoritetet e Shqipërisë.

Në anën tjetër z. Dumani falënderoi për mikpritjen e ngrohtë dhe vlerësoi lart gatishmërinë për të ndarë përvoja dhe ide të vlefshme me interes të përbashkët.

Partneritet i fortë dhe miqësi e qëndrueshme në mes të Policisë së Kosovës dhe FBI-së



Drejtori i Përgjithshëm i PK-së, kolonel Gazmend HOXHA, priti në takim komandantin e KFOR-it, gjeneral Ozkan ULUTAS

Me datën 13 nëntor 2025, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend HOXHA me bashkëpunëtorë, priti në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralin Ozkan ULUTAS, i cili po ashtu ishte i shoqëruar nga stafi i tij. Në takim ndër të tjera u diskutuan tema të ndryshme të cilat ishin në interes të situatës së sigurisë në Republikën e Kosovës. Në takim u konfirmua vazhdimi i bashkëpunimit të mëtejshëm dhe avancimi i shkëmbimit të informacioneve në funksion të ruajtjes së një ambienti më të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët pa dallim. Pikë tjetër e diskutimeve ishin aktivitetet e përbashkëta në mes të PK-së dhe KFOR-it, të cilat reflektojnë në situatën e sigurisë në tërë vendin, përfshirë veriu.



Drejtori Hoxha takohet me shefin e misionit të EULEX-it, z. Barbano

Me datën 09.10.2025 drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha me bashkëpunëtorë, priti në një takim shefin e misionit të EULEX-it në Republikën e Kosovës z. Giovanni Pietro Barbano.

Gjatë këtij takimi u diskutua rreth gjendjes aktuale të sigurisë në vend, si dhe për ngritjen e mëtejshme të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, për ta pasur një ambient sa më të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët pa dallim.

Ndër temat e diskutuara ishte edhe ajo për planifikimin dhe angazhimin policor në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, ku tanimë Policia e Kosovës veçse ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme policore në aspektin e sigurisë.



Ambasadori i BE-së në Kosovë, z. Aivo ORAV takohet me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend HOXHA

Sot, ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë, z. Aivo Orav, u prit në takim nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Prishtinë.

Gjatë takimit, drejtori HOXHA, e njoftoi ambasadorin ORAV për angazhimet dhe prioritetet e Policisë së Kosovës në fushën e sigurisë dhe rendit publik. Palët diskutuan gjithashtu për çështje të ndryshme të sigurisë, sfidat aktuale dhe zhvillimet e përgjithshme në vendin tonë.

Ndër të tjera u theksua rëndësia e vazhimit dhe avancimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, me qëllim të forcimit të mëtejshëm të sigurisë së përgjithshme në vend.



Drejtori i Policisë së Kosovës priti në takim zyrtarët e njësive speciale-elite

Stafi i lartë i Policisë së Kosovës priti në takim zyrtarët e njësive speciale-elite, të cilët ishin pjesë e garës 'King Abdullah Special Operations Training Center' në Jordani, e cila ishte një garë ndërkombëtare e njësive elitare policore/ushtarake, ku pjesëmarrëse kanë qenë 38 ekipe të shteteve të ndryshme të botës, të cilat kanë garuar në disa disiplina me shkallë të lartë të vështirësisë dhe taktikës, si: guajtje me armë të llojeve të ndryshme, marshime me pesha të rënda, përfshirë ushtrime të natyrës së kësaj fushe të operimit policor/ushtarak. Drejtori Hoxha me stafin menaxhues, përgëzuan njësitë elite të PK-së, të cilat me pjesëmarrjen e tyre në këto gara treguan profesionalizëm të lartë, duke arritur rezultate pozitive në fusha të ndryshme karshi policive të shteteve të ndryshme. Ekipi i PK-së ka arritur të futet në pjesën finale të garave 'King Challenge', duke arritur rezultate pozitive karshi ekipeve pjesëmarrëse nga vende të ndryshme të botës.



Partneritet i fortë dhe miqësi e qëndrueshme në mes të Policisë së Kosovës dhe FBI-së

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, ka pritur sot në një takim njoftues Atashen e ri Ligjor të FBI-së, z. Brendan Collins, i cili mbulon Kosovën me seli në Sofje të Bullgarisë.

Në këtë vizitë z. Collins ishte i shoqëruar nga bashkëpunëtorë të FBI-së nga Sofja dhe përfaqësues të Ambasadës së SHBA-së në Kosovë.

Drejtori i Përgjithshëm e falënderoi z. Collins për vizitën e tij në Policinë e Kosovës dhe i uroi suksese në pozitën e re si Atashë Ligjor i FBI-së.

Gjatë takimit u diskutua për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe FBI-së.

Drejtori i Përgjithshëm deklaroi se ky bashkëpunim ka qenë gjithmonë i shkëlqyer dhe ka prodhuar rezultate të prekshme në fushën e sigurisë. Ai shprehu gatishmërinë e tij për të forcuar më tej këtë partneritet në të ardhmen.

Theks i veçantë u vu mbi bashkëpunimin në luftën kundër krimit të organizuar dhe fenomeneve të tjera me interes të përbashkët.



26 VJET NË SHËRBIM TË SIGURISË DHE QYTETARËVE

Policia e Kosovës – histori përkushtimi, besimi dhe profesionalizmi

Në 26-vjetorin e shënimit të Ditës së Policisë së Kosovës, përkujtojmë me krenari rrugëtimin e këtij institucioni, i cili prej themelimit të tij ka qenë simbol i sigurisë, shpresës dhe besimit për qytetarët. Ky përvjetor reflekton historinë e guximit dhe sakrificës së burrave dhe grave që me përkushtim i kanë shërbyer vendit, duke e dëshmuar se misioni i të qenit polic është më shumë se një detyrë – është një thirrje për shërbim ndaj njerëzve dhe atdheut.

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e kësaj dite, Policia e Kosovës organizoi një sërë ngjarjesh policore, sportive dhe kulturore. Demonstrimet e ndryshme para fëmijëve, garat ndërmjet zyrtarëve policorë dhe aktivitetet e përbashkëta me policitë partnere nga rajoni pasqyruan profesionalizmin, përkushtimin dhe frymën e bashkëpunimit që karakterizon institucionin tonë.

Në të njëjtën frymë u zhvilluan edhe ditët e “portës së hapur”, ku qytetarët patën mundësinë të vizitojnë stacionet policore dhe të njihen nga afër me punën dhe ambientet e shërbimit policor, duke forcuar edhe më tej lidhjen e besimit mes policisë dhe komunitetit. Ceremonia solemne e përvjetorit u karakterizua nga respekti e mirënjohja për të gjithë ata që kanë kontribuar në ngritjen dhe zhvillimin e Policisë së Kosovës ndër vite. Me nderim të veçantë u kujtuan policët e rënë në krye të detyrës, të cilët me sakrificën supreme vulosën themelet e sigurisë dhe rendit në Republikën e Kosovës.

Në këtë jubile u promovua edhe Monografia e Policisë së Kosovës, një botim që përmbledh historinë, zhvillimin dhe sukseset e institucionit në shërbim të vendit dhe qytetarëve të tij. Në këto 26 vjet, Policia e Kosovës ka dëshmuar rezultate të larta operationale, përparim profesional dhe transparencë në veprim, duke u shndërruar në një nga shtyllat më të forta të shtetit ligjor.

Në këtë ditë të shënuar Policia e Kosovës shpreh mirënjohje të thellë për mbështetjen dhe besimin e qytetarëve, duke riafirmuar zotimin për të qenë gjithmonë në shërbim të tyre dhe të Republikës së Kosovës – me ndershmëri, profesionalizëm dhe integritet.



MONOGRAFIA E POLICISË SË KOSOVËS, HISTORI, IDENTITET DHE VIZION INSTITUCIONAL

Me rastin e shënimit të 26-vjetorit të Ditës së Themelimit të Policisë së Kosovës, 6 shtator 1999, Policia e Kosovës prezanton për herë të parë monografinë e saj zyrtare – një botim gjithëpërfshirës, dokumentues dhe analitik, që synon të hedhë dritë mbi rrugëtimin historik, institucional dhe profesional të këtij institucioni kyç të shtetit të Kosovës, nga themelimi i tij e deri te zhvillimet bashkëkohore.

Kjo monografi paraqet jo vetëm një arkiv të kujtesës institucionale, por edhe një reflektim të thellë akademik mbi procesin e ndërtimit të një policie moderne, demokratike dhe shumëetnike, në kushte të jashtëzakonshme politike, shoqërore dhe të sigurisë. Ajo dëshmon për transformimin gradual të Policisë së Kosovës nga një shërbim i ri i dalë nga paslufta, në një institucion kushtetues, profesional dhe të besueshëm, i cili sot gëzon besimin e qytetarëve dhe partnerëve vendorë e ndërkombëtarë.

Pjesa qendrore e monografisë i kushtohet periudhës pas përfundimit të luftës, një fazë e karakterizuar nga pasiguri e thellë dhe nevojë urgjente për rend e ligj. Pas 12 qershorit 1999, përgjegjësia për sigurinë publike kaloi fillimisht te KFOR-i dhe Policia e UNMIK-ut. Me mbështetjen e OSBE-së, më 6 shtator 1999 u themelua Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), mbi parimet e policimit demokratik, profesionalizmit dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Themelimi i Akademisë Policore në Vushtrri dhe diplomimi i gjeneratës së parë prej 176 kadetësh në tetor të vitit 1999 shënojnë një moment historik jo vetëm për Policinë e Kosovës, por edhe për vetë procesin e shtetndërtimit. Përbërja shumëetnike dhe përfshirja e grave që në fazat e hershme dëshmojnë orientimin e hershëm të këtij institucioni drejt barazisë, diversitetit dhe përfaqësimit gjithëpërfshirës.

Monografia trajton në mënyrë të detajuar procesin kompleks të tranzicionit të kompetencave nga Policia e UNMIK-ut te SHPK-ja, i cili filloi më 15 qershor 2002 dhe u zhvillua gradualisht, në përputhje me ngritjen e kapaciteteve profesionale, menaxheriale dhe infrastrukturore. Ky proces kulmoi pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, kur, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Policinë, SHPK-ja u riemërtua zyrtarisht në Policia e Kosovës, duke reflektuar konsolidimin e saj si institucion kushtetues i një shteti sovran.

Një vlerë e veçantë e monografisë është trajtimi i zhvillimit të konceptit të policimit në bashkësi, si filozofi pune dhe si model bashkëpunimi me qytetarët dhe institucionet lokale. Krijimi i Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi, Komiteteve Lokale për Siguri Publike dhe mekanizmave të tjerë koordinues paraqitet si një praktikë e avancuar e ndërtimit të sigurisë përmes partneritetit dhe besimit të ndërsjellë.



Monografia ofron një pasqyrë të plotë dhe të strukturuar të organizimit të Policisë së Kosovës në nivel qendror dhe lokal, duke trajtuar në mënyrë analitike rolin dhe funksionin e departamenteve kyçe: Rendit Publik, Njësieve Speciale, Kufirit, Hetimeve, Inteligjencës dhe Analizës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. Ky përshkrim dëshmon për ndërtimin e një strukture moderne, me zinxhir komandues të qartë dhe me kapacitete të specializuara për përballjen me format bashkëkohore të kriminalitetit dhe sfidat e sigurisë.

Një kapitull i veçantë i kushtohet bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar, përfshirë rolin e ILECU-së dhe integrimin e Policisë së Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë të zbatimit të ligjit.

Po ashtu, monografia nderon sakrificën sublime të 24 zyrtarëve policorë të rënë në krye të detyrës, si dhe 25 punonjësve që humbën jetën gjatë pandemisë COVID-19, duke e vendosur humanizmin dhe përkushtimin në qendër të identitetit institucional.

Në tërësinë e saj, monografia e Policisë së Kosovës përfaqëson një dokument referencial me vlerë të lartë historike, institucionale dhe akademike. Ajo nuk është vetëm një përmbledhje faktesh, por një dëshmi e gjallë e rrugëtimin të një institucioni që ka evoluar paralelisht me shtetin e Kosovës. Ky botim shërben si burim i rëndësishëm për studiuesit, profesionistët e sigurisë, median dhe publikun e gjerë, duke konfirmuar se Policia e Kosovës sot është një institucion profesional, modern dhe i përkushtuar ndaj misionit të saj themelor. mbrojtjen e jetës, rendit kushtetues dhe sigurisë së qytetarëve, në përputhje me standardet më të larta demokratike dhe evropiane.

Përgatiti: Çajup Kajtazi

DITA MEMORIALE – NDERIM PËR HERONJTË E POLICISË SË KOSOVËS

Kujtesë, respekt dhe mirënjohje për ata që dhanë jetën në shërbim të vendit

Në ditën memoriale kushtuar zyrtarëve policorë të rënë në krye të detyrës, Policia e Kosovës përkujtoi sakrificën e heronjve të saj, atyre që dhanë jetën në mbrojtje të rendit kushtetues dhe sigurisë në Republikën e Kosovës. Kjo ditë shënon jo vetëm përkujtimin e sakrificës së tyre, por edhe nderimin e përjetshëm ndaj veprës dhe kontributit që kanë lënë pas.

Homazhet pranë lapidarit të policëve të rënë u zhvilluan me pjesëmarrjen e udhëheqjes më të lartë të institucioneve shtetërore dhe menaxhmentit të Policisë së Kosovës. Me përulësi dhe respekt të thellë, u vendosën kurora lulesh në shenjë kujtimi për të gjithë ata që sakrifkuan jetën në shërbim të qytetarëve dhe të vendit.

Në këtë ditë të veçantë, Policia e Kosovës qëndroi pranë familjeve të policëve të rënë, duke shprehur mirënjohjen për forcën dhe qëndrueshmërinë e tyre. Krenaria për sakrificën e më të dashurve të tyre mbetet pjesë e identitetit të institucionit dhe e kujtesës kolektive të shoqërisë sonë.

Përveç homazheve, dita memoriale u shënua edhe me një sërë aktiviteteve sportive e përkujtimore, si: ecje, çiklizëm, vozitje me motorë dhe gara tjera. Këto aktivitete simbolizuan unitetin dhe përkushtimin e zyrtarëve policorë në nderim të kolegëve të tyre, duke ndjekur itinerare që përfshinin zona të ndryshme të vendit, si shenjë e lidhjes së përhershme mes kujtimit dhe misionit të shërbimit.

Në përfundim të aktiviteteve, u shprehën falënderime për të gjithë pjesëmarrësit dhe kontribuuesit në shënimin e kësaj dite, si dëshmi e respektit dhe solidaritetit institucional për ata që dhanë gjithçka për sigurinë e qytetarëve dhe mbrojtjen e integritetit të Republikës së Kosovës.

Zyrtarët e rënë në krye të detyrës mbeten përjetësisht pjesë e historisë dhe krenarisë së Policisë së Kosovës dhe të shtetit tonë. Sakrifika e tyre është frymëzim për brezat që vijnë dhe një kujtesë e vazhdueshme e misionit fisnik të mbrojtjes së paqes, rendit dhe jetës së qytetarëve.

Përgatiti: Arlinda Rexhepi – Gërxhaliu



USHTRIMI I PËRBASHKËT I REAGIMIT NDAJ KRIZAVE – PARTNERITET STRATEGJIK NË VEPRIM

Ky sukses i përbashkët riafirmon angazhimin e palëve për bashkëpunim të thelluar, reagim efikas ndaj krizave dhe siguri të qëndrueshme, në shërbim të qytetarëve dhe të rendit publik

Ushtrimi i përbashkët i reagimit ndaj krizave, i realizuar këtë vit në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, u dëshmuua si një sukses i rëndësishëm operacional dhe strategjik. Ky aktivitet reflekton nivelin e lartë të koordinimit ndërinstitucional dhe forcën e partneritetit të ndërtuar ndër vite.

Në ushtrim morën pjesë rreth 800 zyrtarë të Policisë së Kosovës, së bashku me shërbimet emergjente, si dhe një gamë e gjerë njësisish të specializuara, përfshirë Marrëdhëniet me Publikun. Angazhimi gjithëpërfshirës i këtyre kapaciteteve demonstroi gatishmërinë e Policisë së Kosovës për menaxhimin e situatave komplekse të sigurisë. Ky bashkëpunim i gjerë është dëshmi e besimit të ndërsjellë dhe e përkushtimit të përbashkët për sigurinë dhe stabilitetin.






Skenarët e ushtrimit përfshinë përdorimin e mjeteve taktike dhe ekipeve emergjente, duke forcuar ndërveprueshmërinë dhe procedurat e përbashkëta të reagimit. Ushtrimi shërbeu si platformë e vlefshme për shkëmbim përvojash dhe avancim të standardeve profesionale.

Për Policinë e Kosovës, ky ushtrim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt fuqizimit të kapaciteteve operationale dhe përafrimit të vazhdueshëm me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Partneriteti me Ambasadën Amerikane mbetet një shtyllë strategjike në ndërtimin e një force policore moderne, profesionale dhe të besueshme.

Ky sukses i përbashkët riafirmon angazhimin e palëve për bashkëpunim të thelluar, reagim efikas ndaj krizave dhe siguri të qëndrueshme, në shërbim të qytetarëve dhe të rendit publik.

Përgatiti: Daut Hoxha



MAJORJA E POLICISË SË KOSOVËS DIPLOMON NË AKADEMINË KOMBËTARE TË FBI-SË



Më 11 dhjetor 2025, major Luljeta Mehmeti - Quigley ka diplomuar me sukses si pjesëtare e Sesionit të 296-të të Akademisë Kombëtare të FBI-së. Ceremonia e diplomimit u mbajt në Akademinë e FBI-së në Quantico, Virxhinia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Major Mehmeti - Quigley mori pjesë në një grup të përzgjedhur të zyrtarëve të lartë të zbatimit të ligjit që përfundojnë këtë program prestigjioz dhe është një nga pak zyrtarët në historinë e Policisë së Kosovës që ka diplomuar nga Akademia Kombëtare e FBI-së. Në nivel të Shteteve të Bashkuara dhe ndërkombëtar, më pak se një për qind e zyrtarëve të zbatimit të ligjit kanë mundësinë të ndjekin këtë trajnim elitare në nivel ekzekutiv.

E njohur ndërkombëtarisht për përsosmëri akademike, Akademia Kombëtare e FBI-së ofron 11 javë trajnim të avancuar në leadership, komunikim, shkenca të sjelljes, përgatitje fizike dhe praktika bashkëkohore të zbatimit të ligjit. Pjesëmarrësit përzgjidhen bazuar në performancë të dëshmuar profesionale dhe potencial udhëheqës. Mesatarisht, zyrtarët e diplomuar kanë mbi 20 vjet përvojë në zbatimin e ligjit dhe kthehen në agjencitë e tyre për të shërbyer në pozita të larta udhëheqëse dhe strategjike.

Sesioni i 296-të përbëhet nga 254 zyrtarë të zbatimit të ligjit që përfaqësojnë 47 shtete të SHBA-së dhe Distriktin e Kolumbisë, si dhe zyrtarë nga 24 shtete të botës, katër organizata ushtarake dhe dy agjenci federale civile, duke theksuar dimensionin e fuqishëm ndërkombëtar dhe ndërinstitucional të Akademisë.

Diplomimi i majores Mehmeti - Quigley nga Akademia Kombëtare e FBI-së pasqyron profesionalizmin, leadershipin dhe përkushtimin e saj ndaj punës në Policinë e Kosovës. Ky sukses forcon kapacitetin institucional të Policisë së Kosovës dhe përforcon përkushtimin ndaj standardeve moderne, demokratike dhe të harmonizuara ndërkombëtarisht të policimit.

Pjesëmarrja e saj në Akademinë Kombëtare të FBI-së rrit më tej aftësinë e Policisë së Kosovës për të zbatuar praktikatat më të mira ndërkombëtare, për të forcuar partneritetet dhe për të kontribuar në sigurinë publike për të gjitha komunitetet në Kosovë.

Përgatiti: Blerinë Ejupi-Tahiri



KOSOVA, E PARA PËR SIGURI NË RAJON DHE TRETA NË NIVEL BOTËROR

Siguria publike

Bazuar në hulumtimet dhe burimet ndërkombëtare, organizatave joqeveritare dhe raporteve rajonale, me qëllim analizimin e gjendjes së sigurisë publike dhe veçanërisht sigurisë në trafikun rrugor në Kosovë për periudhën 2023–2025, Kosova renditet ndër vendet më të sigurta në botë, sipas Gallup Global Law and Order Index (2024–2025), është indeks që mat perceptimin e qytetarëve lidhur me ndjenjën e sigurisë, besimin në zbatimin e ligjit dhe përvojat direkte me kriminalitetin. Raporti më i ri ndërkombëtar Gallup Global Safety Report 2025, i publikuar në fillim të muajit shtator, ka renditur Kosovën ndër vendet më të sigurta në botë, duke e pozicionuar të tretën në nivel global dhe të parën në Evropë për ndjenjën e sigurisë së qytetarëve dhe besimin ndaj institucioneve të zbatimit të ligjit.

Sipas këtij raporti, Kosova ka arritur rezultat 94 pikë nga 100 në Indeksin e Ligjit dhe Rendit, duke u renditur menjëherë pas Taxhikistanit (97 pikë) dhe Singaporit (95 pikë), si tri vendet më të sigurta në botë. Ky rezultat e bën Kosovën vendin më të sigurt në Evropë, duke lënë pas shtete të zhvilluara si Islanda, Norvegjia, Austria dhe Zvicra.

Po ashtu, raporti thekson se 89% e qytetarëve të Kosovës ndihen të sigurt duke ecur vetëm natën në zonën ku jetojnë, përqindje që e vendos Kosovën në mesin e vendeve me nivelin më të lartë të perceptimit të sigurisë në botë dhe në Evropë.

Ndërsa Global Organized Crime Index apo Indeksi Global i Krimit të Organizuar, i publikuar nga Global Initiative Against Transnational Organized Crime (GI-TOC), vlerëson nivelin e krimit të organizuar dhe kapacitetin institucional të shteteve për t'u përballur me të përmes qeverisjes, zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Ky indeks përfshin edhe aktivitetet kriminale të tilla si trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimi kibernetik.

Në raportet e viteve 2023–2025, Kosova vlerësohet me një nivel relativisht të ulët të krimit të organizuar në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Sipas rezultateve të këtij indeksi për vitin 2025, i cili mat 15 tregje kriminale, 5 lloje akterësh kriminalë dhe 12 blloqe të qëndrueshmërisë, të publikuar nga Global Initiative Against Transnational Organized Crime, Kosova vlerësohet me nivelin më të ulët të kriminalitetit në Ballkanin Perëndimor, me një mesatare prej 4.85 pikësh në një shkallë vlerësimi nga 1 deri në 10.

Një kontribuues kyç dhe i veçantë në arritjen e këtyre rezultateve pozitive është Policia e Kosovës me leadershipin dhe zyrtarët e saj, e cila përmes planeve zhvillimore strategjike dhe objektivave të veçanta në luftimin e të gjitha formave të krimit, ka rritur të ketë rezultate të theksuara ndër vite, e që e bëjnë Kosovën si vendi me nivelin më të ulët të krimit në Ballkanin Perëndimor.

2024 Law and Order Index Scores: Europe



The Law and Order Index measures security levels that respondents report for themselves and their families. Two elements make up this index: one composed of respondents' reported confidence in local police and feeling safe walking alone at night, and the other of two questions about respondents' experiences with crime.

Country / Territory	Index Score
 Kosovo	94
 Iceland	93
 Norway	92
 Austria	91
 Switzerland	91
 Denmark	90
 Finland	90
 Montenegro	90
 Estonia	88
 Germany	88
 Portugal	88
 Sweden	88
 Czech Republic	87
 Netherlands	87


Law and Order Index

Countries/Territories With Highest Law and Order Index Scores

Country	Index Score
 Tajikistan	97
 Singapore	95
 Kosovo	94
 China	93
 Iceland	93
 Vietnam	93
 Norway	92
 Austria	91
 Bahrain	91
 Oman	91
 Saudi Arabia	91
 Switzerland	91
 Uzbekistan	91



Siguria në trafikun rrugor mbetet një nga sfidat kryesore të sigurisë publike në Kosovë. Analiza e mëposhtme kombinon statistikën policore me të dhëna dhe vlerësime ndërkombëtare nga Transport Community dhe organizata të tjera rajonale. Sipas raportit të Transport Community, i publikuar më 12 nëntor 2025, me të dhënat e vitit 2024, Kosova ka arritur rezultate pozitive edhe në sigurinë rrugore, duke pasur numrin më të ulët të viktimave për një milion banor në aksidente fatale, krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor.



Transport Community, një organizatë rajonale e mbështetur nga Bashkimi Evropian, raporton se në vitin 2024 viktimat e aksidenteve rrugore në Kosovë ranë me rreth 8,5% krahasuar me vitin 2023.

Të dhënat tregojnë se viti 2024 shënoi një përmirësim të dukshëm në uljen e fataliteteve në trafik, gjë që përputhet me vlerësimet rajonale të Transport Community për Ballkanin Perëndimor, ku Kosova paraqitet më mirë se disa vende të rajonit. Policia e Kosovës, përmes zbatimit të planeve operacionale, fushatave sensibilizuese e aktiviteteve të ndryshme policore, edhe në fushën e trafikut, do të vazhdojë me përkushtim me rezultatet më të mira krahas vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Përgatiti: Luljeta Mehmeti-Quigley

NJIHUNI ME POLICIN E LAGJES TUAJ!



Policia e Kosovës, me qëllim të ofrimit të sigurisë dhe për të qenë sa më afër qytetarit, ka krijuar projektin “Njihuni me policin tuaj”. Me rastin e promovimit të këtij projekti i cili është i bazuar në strategjinë e Policimit në Bashkësi dhe Policimit të Drejtuar nga Inteligjenca, me 14 tetor 2022 ishte mbajtur takimi dhe konferenca për media me rastin e promovimit të projektit në fjalë.

Policia e Kosovës, me anë të implementimit të këtij projekti, synon rritjen e mëtejme të bashkëpunimit dhe partneritetit me qytetarët, krijimin e mundësisë për qytetarët e interesuar të njohin policët e lagjes së tyre. Ky projekt i cili filloi së implementuari fillimisht në dy drejtoritë rajonale policore, atë të Prishtinës dhe të Mitrovicës Veri, për të vazhduar më pastaj edhe në të gjitha rajonet dhe stacionet policore, do të ndikojë edhe më tej në rritjen e bashkëpunimit të drejtë me qytetarët dhe ngritjen e nivelit të sigurisë në vend.

Në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm dhe perfeksionimit të punës së policëve të lagjes, mbahen trajnime të vazhdueshme në fusha të ndryshme. Gjatë trajnimeve prezantohen dhe diskutohen detajet më të rëndësishme të punës që do ta kryejnë policët e sektorëve, referuar bazës ligjore, Planit të Veprimit të Strategjisë së Policimit të Drejtuar nga Inteligjenca dhe Policimit në Bashkësi, si dhe procedurat standarde të veprimit për Policimin në Bashkësi.

Janë trajnuar gjithsejtë 42 pjesëtarë të Policisë si trajner nga të gjitha drejtoritë rajonale dhe stacionet policore. Në fund të trajnimit u janë shpërndarë certifikatat e trajnerëve dhe u janë dhënë materiale për trajnim.

Gjatë trajnimeve po ashtu është ritheksuar rëndësia e partneritetit me qytetarë në parandalimin e krimit, krijimi i raporteve të mira dhe avancimi i besueshmërisë së publikut, adresimi i kërkesave të qytetarëve dhe trajtimi i shqetësimeve për çështje të sigurisë. Me policët është diskutuar avancimi i komunikimit me qytetarë dhe si krijimi dhe mirëmbajtja e marrëdhënive të mira në funksion të sigurisë së të gjithë qytetarëve.

Policia e Kosovës në vazhdimësi ka synuar rritjen e efikasitetit në punën e policëve të lagjes, me qëllim që ata të jenë sa më afër komunitetit dhe nevojave të qytetarëve. Për të lehtësuar mbulimin e zonës së përgjegjësisë dhe për të shpërblyer angazhimin e policëve nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha u ndanë rreth 19 vetura të reja hibride.



Kjo edhe një herë dëshmon përkushtimin e menaxhmentit të Policisë për një qasje gjithnjë e më proaktive ndaj komunitetit, për forcimin e bashkëpunimit dhe komunikimit me qytetarët, si dhe për rritjen e mëtejme të besueshmërisë dhe transparencës institucionale.

Policia është populli dhe populli është Policia!

Përgatiti: Blerinë Ejupi-Tahiri

INTERVISTË ME KOLONEL NESHAT FLUGAJN

Përmes kësaj interviste për 'MBROJTËSIN' do të rrugëtojmë nëpër vite duke shpalosur profesionalizmin dhe përkushtimin që i keni dhënë Policisë, duke shërbyer ndershëm dhe bindshëm.

Ju falënderojmë që keni gjetur kohë të na përgjigjeni!

Nga cili vit keni qenë zyrtar policor, përshkruaj pak fillimin, emocionet e të qenit shërbyes në Polici?

Para se të isha polic isha ushtar në Eskadrilën e Helikopterëve, mirëpo me kalimin e kohës vlerësova se kontributi im në shërbim të qytetarëve do të ishte më i madh dhe më i nevojshëm si pjesëtar i Policisë dhe vendosa që karrierën time ta vazhdoj që nga viti 2003 si pjesëtar i Shërbimit Policor të Kosovës.

Fillimi ishte mjaft sfidues, nga fakti se vendi ende përballlej me vuajtje dhe problemet e ndryshme të përjetuara gjatë luftës. Të isha pjesë e policisë së vendit pas një lufte shkatërruese, nuk ishte thjesht një vend pune, por ishte një mision shpirtëror. Emocionet ishin të thella, të ndërlikuara dhe shpesh përziheshin me krenari, dhimbje dhe përgjegjësi. Ndjenja për të vendosur rend dhe ligj dhe ofrimi i sigurisë për qytetarët dhe për të mos lejuar që dhuna e së kaluarës të përsëritet, besimi se përmes disiplinës, ndershmërisë dhe përkushtimit, vendi mund të ngrihet dhe të ecë drejt një të ardhmeje më të sigurt, ishin shtytje për angazhim të palodhshëm si pjesëtar i Policisë.

Duhej durim, ndershmëri dhe sjellje shembullore, për të ndërtuar ura ndërmjet Policisë dhe popullit, në mes të ligjit dhe drejtësisë, me një fjalë të jesh polic pas luftës do të thotë të mbash uniformën me nder, jo për të demonstruar forcë, por me zemër e shpirt t'iu shërbesh të gjithë qytetarëve të vendit, përkushtim ndaj paqes, sigurisë dhe drejtësisë.

Si e shihni zhvillimin e Policisë nga fillimet e saj e deri më sot?

Atëherë kur më shumë se uniforma na bashkonte dëshira për t'i shërbyer vendit, vullneti dhe angazhimi jonë i pa rezervë bënte që ne të aftësohemi shumë shpejt në përmbushjen e detyrave policore dhe t'iu shërbejmë me përkushtim qytetarëve tonë pa dallim dhe me krenari e profesionalizëm të ofrojmë rend e siguri në tërë vendin.

Shumë shpejt Policia e Kosovës, përmes trajnimeve të brendshme dhe trajnimeve ndërkombëtare, u konsolidua, u aftësua dhe u profesionalizua që të përballlej dhe t'i luftojë të gjitha llojet e shkeljeve ligjore e deri te krimet e organizuara dhe menaxhimin e situatave kritike, në tërë territorin e vendit.

Sot, Policia e Kosovës, është ngritur në një polici të respektuar e profesionale, në nivel të policive rajonale dhe më gjerë.

Policia e Kosovës, sot ka avancuar dhe ka investuar në teknologji, trajnime të avancuara dhe të specializuara, ka bashkëpunime me simotrat ndërkombëtare dhe është pajisur me pajisjet më të avancuara për luftimin e krimit dhe mbrojtjen e rendit dhe ligjit në tërë territorin e vendit.

Me profesionalizmin e arritur, Policia e Kosovës, sot me të drejtë vlerësohet si njëra ndër institucionet më të besueshme në vend, por edhe polici e respektuar në nivelin ndërkombëtar.



Cilat ishin etapat kryesore në karrierën tuaj profesionale?

Puna e Policisë dhe shërbimi ndaj qytetarëve dhe vendit në përgjithësi e përmbush fotografinë complete të karrierës së një zyrtari policor nga fillimi e deri në ditën e pensionimit.

Ecuria ime profesionale nëpër etapa do të ishte fillimisht pranimi në Akademinë Policore të cilën do ta përshkruaja si fazë sfiduese me shumë emocione të mbështjellë me krenari, pastaj caktimi në pozitën e instruktorit në Akademinë Policore, ku përgatitja ime shkollore dhe përvoja paraprake më ndihmoi të ofroja kontributin tim profesional në përgatitjen e policëve të ardhshëm. Në Akademinë Policore shërbeva me shumë përkushtim, fillimisht në Sektorin e Policisë së Përgjithshme e pastaj edhe në Sektorin e Trajnimeve të Specializuara dhe të Avancuara, e në fund edhe në Sektorin për Trajnime të Menaxhmentit.

Etapa e gradimeve, ishte një etapë konkurruese që shkollimi, përvoja përkushtimi dhe dëshira për pranimin e obligimeve shtesë nga pozita e menaxherit, kanë bërë që gjatë karrierës sime, t'i kaloj testimet për gradim duke arritur gradën kolonel.

Pastaj u caktova në pozitën e drejtorit të Njësisë të Specializuara, që po ashtu ishte një fazë plotë sfida e momente krenarie. Shkollimi im paraprak (Shkolla e Mesme Policore, Akademia Ushtarake, Fakulteti Juridik dhe sërish kursi në Akademinë Policore) dhe përvoja ime profesionale, më ndihmuan që shpejt ta kuptoj natyrën e punës së këtyre njësisë dhe të identifikoj nevojat që këto njësi të ngrihen në njësi profesionale për luftimin e krimit si dhe në njësi operative për mbrojtjen e sovranitetit shtetëror. Angazhimi im ishte i përqendruar në ngritjen e performancës së të gjithë pjesëtarëve të këtij divizioni dhe përshtatja e trajnimeve problematikave të kohës, centralizimi i Njësisë Speciale Operative, si dhe pajisja e këtyre njësisë me pajisje të nevojshme për përmbushjen e misionit, si dhe përfunduar profilizimin e këtyre njësisë brenda vetë Divizionit.

Sot, këto njësi, janë ndër njësitet më të përgatitura dhe më profesionale në rajon dhe më gjerë. Angazhim i veçantë ishte përgatitja e kuadrit mbikëqyrës e që sot eprorët e dalë nga ky divizion udhëheqin departamentet dhe stacionet policore më të rëndësishme të vendit.

Si do ta përshkruaje ndjenjën e një të uniformuari (përshkruaj vlerën, përparësitë dhe vështirësitë kur je në uniformë)?

Të qenit pjesëtar i Policisë në uniformë është një ndjenjë e përzier mes krenarisë, besimit, profesionalizmit dhe përgjegjësisë. Uniforma është pasqyrë e shërbimit, e disiplinës, e besimit, respektit dhe bashkëpunimit.

Uniforma të bën krenar dhe të rëndësishëm. Të jep autoritet e respekt, duke bërë që të tjerët të të besojnë dhe person që ofron siguri.

Uniforma gjithashtu sjell edhe sfida dhe vështirësi. Çdo hap që bën, çdo vendim që merr kur je në uniformë, të mban nën presion për të vepruar drejt, por edhe pritja që gjithmonë të sjell edhe stres. Orët e gjata të punës, rreziqet dhe përgjegjësia shpesh ndikojnë edhe në jetën familjare. Çdo kritikë, sjellje e keqe në uniformë, ose edhe ndonjë gabim i lëshuar do të ndikojë, jo vetëm tek polici, por edhe në reputacionin e tërë organizatës.

“Uniforma nuk është privilegj, është simbol besimi, guximi, sakrifice dhe respekti për qytetarët”

A mund të flisni diçka për jetën personale, (shkollimi, familja, ndonjë profesion të mëparshëm, ndonjë hobi-sport, art apo diçka që vlerësoni për të na e thënë)?

Jam i lindur në fshatin Kapre komuna e Dragashit. I martuar, baba i dy fëmijëve, e tani edhe gjysh. Shkollën fillore e kam kryer në vendlindje. Shkollën e Mesme të Punëve të Brendshme e kam kryer në Vushtrri. Pas përfundimit të shkollës së mesme kam punuar si polic në ish Njësinë e Veçantë në Prishtinë. Kam përfunduar Akademinë Ushtarake të Aviacionit (ish Jugosllavi) në Zarë dhe Mostar. Pas përfundimit të Akademisë, kam punuar si pilot në Njësinë e Helikopterëve të ish Sekretariatit Krahinor të Punëve të Brendshme deri në vitin 1990, kur edhe jemi larguar nga puna nga pushteti i atëhershëm serb. Si pilot kam arritur aftësimin më të lartë profesional në aviacion dhe kam marrë titullin instruktor i fluturimit dhe ekspert për hetimin e incidenteve dhe aksidenteve ajrore.

Pas largimit nga puna jam marrë me angazhime sindikale policore deri në fillimin e luftës.

Në vitin 1995 kam përfunduar edhe Fakultetin Juridik.

Pas përfundimit të luftës kam vazhduar si pjesëtar i Njësisë Ajrore të TMK-së.

Hobi apo pasion kam leximin. Më pëlqen çdo sport, por veçanërisht futbolla.

Si do ta përshkruaje Policinë e Kosovës me pak fjalë nga këndvështrimi i një pensionisti duke përmendur mundësitë dhe aftësitë e zyrtarëve të saj?

Nga këndvështrimi i një pensionisti, PK-në do ta përshkruaj si një institucion profesional të përkushtuar në shërbim të qytetarëve dhe mbrojtjes së rendit dhe ligjit në tërë vendin. Zyrtarët e Policisë dallohen për profesionalizëm, disiplinë, guxim dhe gatishmëri për t'iu shërbyer sa më mirë qytetarëve.

Përmes punës së tyre të përditshme, policët dëshmojnë aftësi, besueshmëri dhe përkushtim në mbrojtjen e jetës, pronës dhe rendit ligjor të vendit.

Me të drejtë, nga qytetarët, Policia e Kosovës vlerësohet si institucioni më i besueshëm në vend.

Të lutem një mesazh për të gjithë punonjësit dhe të rinjtë që marrin hapin drejt këtij institucioni?

Mesazhi im për të gjithë punonjësit dhe të rinjtë që i bashkohen Policisë së Kosovës do të ishte:

Të jesh pjesë e PK- së është më shumë se një vend pune, është përgjegjësi, nder dhe shërbim ndaj vendit dhe qytetarëve të saj.

Uniforma që bartni nuk është privilegj, është simbol besimi, guximi, sakrificë dhe respekti për qytetarët!

Ju falënderojmë përzemësisht për kontributin tuaj të pakrysyshëm që me vite i keni dhënë Policisë, gjithashtu ju falënderojmë që ju përgjigjet ftesës sonë për këtë intervistë!

Ju dëshirojmë shëndet të plotë dhe jetë të rehatshme pensionale.

Përgatiti : Merita Canolli- Gashi

MISION I SHËNDETIT, DISIPLINËS DHE PËRFAQËSIMIT ME DINJITET

Policia e Kosovës që nga themelimi i saj e ka përfshirë sportin si pjesë përbërëse të kulturës dhe zhvillimit të brendshëm organizativ. Sporti nuk është parë thjeshtë vetëm si aktivitet fizik, por si një instrument i fuqishëm për ndërtimin e disiplinës, forcimin dhe përgatitjen fizike dhe psikologjike të pjesëtarëve policorë, si dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe krijimit të lidhjeve të shëndosha me komunitetin.



Sporti, pjesë e identitetit organizativ

Policia e Kosovës zhvillon rregullisht aktivitete sportive e në veçanti për përvjetorë institucionale, festa kombëtare si dhe ndërkombëtare, po ashtu zhvillon aktivitete edhe në bashkëpunim me institucionet tjera të sigurisë. Pjesëmarrja në gara vendore dhe ndërkombëtare është kthyer në një traditë që përforcon imazhin profesional dhe kulturën e shëndetshme të Policisë së Republikës së Kosovës.

Disa nga disiplinat më të përfaqësuara në sportin e PK-së janë: futboli, basketboll (femra dhe meshkuj), volejboli, atletika, xhudo, karate, shenjëtari (qitje), shah etj. të cilat janë mënyra më e mirë për ruajtjen e formës fizike, zhvillimin personal, motivimin dhe ndërtimin e frymës ekipore, që përkthehet drejtpërdrejt në performancë më të lartë në shërbim.

Policia e Kosovës vlerëson çdo pjesëtar të saj i cili pa u kursyer angazhohet në aktivitetet sportive, duke filluar që nga përkushtimi personal, të cilët qëndrojnë pas çdo suksesi sportiv.

Sportistët e Policisë së Kosovës, të cilët me punë vullnetare dhe profesionale kanë ndërtuar ekipe, kanë trajnuar kolegë dhe kanë përfaqësuar Policinë e Kosovës me dinjitet brenda dhe jashtë vendit, janë krenaria e Policisë së Kosovës dhe njëkohësisht frymëzim për të tjerët.

Ndër vite sporti në PK ka arritur rezultate të cilat kanë qenë motivim për një angazhim të më tutjeshëm. Medaljet, trofetë dhe titujt e kampionëve, janë dëshmi e përkushtimit dhe pasionit që ekziston brenda strukturave të policisë për sportin dhe për vlerat që ai përfaqëson.



Shoqata e sporteve, një epokë e re për sportin policor Me iniciativën dhe mbështetjen e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës kolonel Gazmend Hoxha, si dhe strukturave udhëheqëse, në vitin 2024 u themelua Shoqata e Sporteve të Policisë së Kosovës.

Shoqata e Policisë së Kosovës vjen si një formë organizimi i ri dhe modern, që shënon një kthesë pozitive në mënyrën e strukturimit dhe funksionimit të sportit brenda Policisë së Kosovës.

Në kuadër të kësaj shoqate, janë themeluar dhe janë regjistruar në federatat përkatëse tetë klube sportive zyrtare si:

1. Klubi i Shenjëtarisë (Qitje)
2. Klubi i Shahut
3. Klubi i Xhudos
4. Klubi i Karatesë
5. Klubi i Atletikës
6. Klubi i Basketbollit (femra dhe meshkuj)
7. Klubi i Volejbollit
8. Klubi i Futbollit

Këto klube tashmë janë aktive në gara profesionale dhe po arrijnë suksese konkrete, duke e rritur profilin e Policisë si institucion që promovon sportin dhe vlerat shoqërore përmes tij.





Sporti, mjet komunikimi dhe afërsie me komunitetin
 Sporti është urë lidhëse midis Policisë dhe komunitetit. Përmes pjesëmarrjes në gara, aktiviteteve me të rinjtë dhe organizimet publike, Policia e Kosovës forcon besimin, respektin dhe bashkëpunimin me qytetarët. Policët nuk shihen vetëm si zyrtarë të ligjit, por edhe si pjesë aktive e jetës sociale dhe kulturore, si sportistë, bashkëpunëtorë dhe frymëzues të brezit të ri. Ky dimension promovon një qasje më njerëzore dhe afatgjate në marrëdhënien me publikun, ku sporti bëhet platformë për ndërtimin e partneritetit dhe raportimit të dukurive negative në mënyrë më të natyrshme dhe efektive.

Barazia gjinore në sport, vlerë themelore në Policinë e Kosovës
 Policia e Kosovës është shembull i qasjes gjithëpërfshirëse dhe promovimit të barazisë gjinore në sport. Zyrtarët policore janë pjesëmarrëse aktive në shumicën e disiplinave sportive, shpesh si udhëheqëse klubesh, trajnere apo bartëse të medaljeve dhe përfaqësuese të vendit në gara vendore dhe ndërkombëtare. Përfshirja e tyre nuk është vetëm simbolike, është jetike për ndërtimin e ekipeve më të forta dhe më të balancuara. Kjo qasje përçon mesazhin e fuqishëm se sporti brenda Policisë është i hapur për të gjithë, pa dallim gjinie apo pozite.

Policia e Kosovës, model për institucionet tjera publike
 Përmes themelimit të Shoqatës së Sporteve dhe organizimit profesional të klubeve të saj, Policia e Kosovës ka vendosur një standard të ri për sportin institucional. Ky model tashmë është duke u ndjekur nga organizata të tjera të sigurisë dhe institucione publike që duan të zhvillojnë sportin si pjesë e kulturës së brendshme organizative.



Sporti, pjesë e rrugëtimit profesional!
 Të jesh pjesë e Policisë së Kosovës do të thotë më shumë sesa të shërbesh. Do të thotë të jesh pjesë e një komuniteti që mbështet zhvillimin fizik, kulturor dhe personal të zyrtarëve të vet. Sporti në Policinë e Kosovës nuk është vetëm rekreacion, është mision, është përgjegjësi dhe është mundësi për përfaqësim me dinjitet brenda dhe jashtë kufijve të vendit. “Të jesh pjesë e Policisë së Kosovës nuk është vetëm shërbim, është një rrugëtim drejt disiplinës, suksesit dhe përfaqësimit me dinjitet, në sport, në kulturë dhe në shërbim ndaj vendit.” Policia e Kosovës vazhdon të jetë shembull për të rinjtë, për institucionet dhe për shoqërinë, jo vetëm si garantuese e sigurisë, por edhe si promotor i shëndetit, barazisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm përmes sportit.

Përgatiti: Arlinda Rexhepi – Gërxhaliu

EKIPI I POLICISË SË KOSOVËS ARRIN NË FINALEN E GARËS NDËRKOMBËTARE NË JORDANI

Njësia elite e PK-së, ndër më të suksesshmet në mesin e 38 ekipeve botërore

Njësitë elite të Policisë së Kosovës kanë shënuar një tjetër sukses të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare, duke përfaqësuar me dinjitet dhe profesionalizëm institucionin dhe shtetin e Kosovës në garën prestigjioze të njësive speciale “King Abdullah II Special Operations Training Center (KASOTC)”, e cila u zhvillua gjatë muajit tetor 2025 në Mbretërinë Hashemite të Jordanisë.

Këtë vit, gara mbledhi 38 ekipe elitare policore dhe ushtarake nga vende të ndryshme të botës. Ajo njihet për nivel të lartë vështirësie, me prova që testojnë aftësitë operative, fizike dhe taktike të pjesëmarrësve – nga gjuajtjet me armë të ndryshme, marshimet me peshë të rëndë, e deri të ushtrimet e ndërlikuara taktike që kërkojnë koordinim, qëndrueshmëri dhe vendimmarrje të shpejtë nën presion.




Në mesin e kësaj konkurrence të fortë ndërkombëtare, ekipi i Policisë së Kosovës arriti të kualifikohet në fazën finale, ku përzgjidhen vetëm 15 ekipet më të suksesshme me rezultatet më të larta. Kjo renditje e nderon institucionin dhe vendin, duke dëshmuar standardet e larta profesionale dhe përgatitjen që posedojnë njësitë speciale të PK-së.

Në shenjë respekti për këtë arritje të çmuar, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, së bashku me stafin e lartë të PK-së, priti në takim zyrtar pjesëtarët e njësive elite që morën pjesë në garë.

Gjatë këtij takimi, drejtori Hoxha përgëzoi zyrtarët për përfaqësimin dinjitoz, duke theksuar se suksese të tilla janë burim frymëzimi dhe motivimi për të gjithë Policinë e Kosovës. “Rezultatet e arritura në gara të kësaj natyre ndërkombëtare pasqyrojnë jo vetëm profesionalizmin e zyrtarëve tanë, por edhe imazhin pozitiv dhe reputacionin në rritje të Policisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare”, u shpreh kolonel Hoxha.

Pjesëmarrja e Policisë së Kosovës në garën KASOTC dhe arritja në mesin e më të mirëve të botës përforcon rolin e saj si institucion modern, i përkushtuar ndaj trajnimit, disiplinës dhe standardeve më të larta të sigurisë.

Përgatiti: Arlinda Rexhepi – Gërxhaliu





KOSOVË, 2025

POLICE

OPERACIONE SPECIALE

TOP OPERACIONET

1

OPERACIONI POLICOR, I ZHVILLUAR NË KATËR RAJONE TË KOSOVËS, QË IU DHA FUND INSTITUCIONEVE TË JASHTËLIGJSHME

Policia e Kosovës me njesitë e saja relevante, me datën 15 janar 2025, në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës, ka realizuar një operacion të gjerë policor, të shtirë në disa rajone të Kosovës: Prishtinë, Gjilan, Gjakovë dhe Mitrovicë Jug.

2

POLICIA E KOSOVËS ZBULON NJË LABORATOR TË MADH FALSIFIKIMIN E DOKUMENTEVE

Policia e Kosovës në vazhdim të realizimit të aktiviteteve të bazuara në planin zhvillimor strategjik për ofrim të kujdesit dhe ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, më 24.01.2025 ka ndaluar një automjet me targë vendore ku gjatë kontrollit në automjet është gjetur sasi shumë e madhe e dokumenteve blanko (të zbrazëta) të shteteve të ndryshme.

Operacioni policor, i zhvilluar në katër rajone të Kosovës, që iu dha fund institucioneve të jashtëligjshme

Policia e Kosovës me njësitë e saja relevante, me datën 15 janar 2025, në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës, ka realizuar një operacion të gjerë policor, të shtrirë në disa rajone të Kosovës: Prishtinë, Gjiilan, Gjakovë dhe Mitrovicë Jug. Qëllimi i këtij operacioni policor ka qenë ndërprerja e aktiviteteve të institucioneve të jashtëligjshme që vepronin, si: komuna, posta, banka etj., të cilat ofronin shërbime të jashtëligjshme, kundër rendit kushtetues dhe ligjeve pozitive të Republikës së Kosovës. Policia e Kosovës, bazuar në kërkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ka asistuar zyrtarët e kësaj ministrie si dhe të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për ndërprerjen e aktiviteteve të jashtëligjshme të këtyre institucioneve, duke siguruar kështu vendosjen e rendit dhe ligshmërisë.



Policia e Kosovës zbulon një laborator të madh falsifikimin e dokumenteve

Policia e Kosovës në vazhden e realizimit të aktiviteteve të bazuara në planin zhvillimor strategjik për ofrim të kujdesit dhe ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, më 24.01.2025 ka ndaluar një automjet me targa vendore ku gjatë kontrollit në automjet është gjetur sasi shumë e madhe e dokumenteve blanko (të zbrazëta) të shteteve të ndryshme.

Gjatë kontrollit më të detajuar të këtij automjeti Njësia për Hetimin e Dokumenteve të Falsifikuara nga Drejtoria për Hetim e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit ka gjetur 16 valixhe të mbushura me dokumente të ndryshme (të pa plotësuar -blanko) si: pasaporta, karta identiteti, patentë shoferë si dhe materiale të ndryshme që shërbejnë për falsifikimin e dokumenteve, holograma etj.

Lidhur me këtë rast Policia e Kosovës ka ndërmarrë veprime intensive në hetimin dhe zbulimin e lokacionit ku prodhoheshin këto dokumente të falsifikuara, me çrast pas hetimeve intensive është arritur të sigurohet informacioni se në një shtëpi në Prishtinë, mund të ketë pajisje që shërbejnë për prodhimin e dokumenteve të falsifikuara.

Gjatë kontrollit është konstatuar se kemi të bëjmë me një laborator ku ndodhesin pajisje që shërbejnë për prodhim të dokumenteve si pasaporta, letërnjoftime, leje qëndrimi, patentë shofer etj.

Pajisjet ishin si makina llaserike të ndryshme, printer të ndryshëm dhe shumë pajisje të tjera si dhe dokumente të zbrazëta (blanko) të shteteve të ndryshme.

Policia e Kosovës prangos të dyshuarin që komprometoi mbi 300 mijë kartela bankare në një shtet të BE-së

Policia e Kosovës ka zhvilluar një operacion të suksesshëm hetimor në Prishtinë dhe Ferizaj, i cili ka rrjedhur pas një hetimi disa mujor, ku është arrestuar një person i dyshuar për hyrje të paautorizuar kompjuterike në një bankë të një shteti të BE-së.

Ky veprim ka rezultuar në komprometimin e të dhënave të mbi 300 mijë kartelave bankare, duke shkaktuar dëm të konsiderueshëm. Gjatë realizimit të operacionit të kontrollit janë sekuestruar katër kompjuterë, tre telefona, një USB dhe dokumente të rëndësishme.

Bashkëpunimi i ngushtë ndërkombëtar dhe profesionalizmi i lartë i Policisë së Kosovës kanë qenë kyç në këtë operacion. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar në luftimin e krimeve kibernetike edhe në nivel të avancimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe forcimin e sigurisë publike.

Policia e Kosovës kap mbi 32 kg drogë të fshehur në automjetin me targa serbe

Drejtorja për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë (DHTN) nga Policia e Kosovës, ka realizuar një operacion të suksesshëm në rajonin e Mitrovicës së Veriut, ku ka parandaluar transportimin e një sasive të konsiderueshme narkotikësh. Me datën 24 mars 2023 nga Policia e Kosovës është realizuar një operacion në Pikën e Kalimit Kufitar Republika e Kosovës–Serbi në Jarinjë, ku një automjet i dyshuar me targa serbe është përzgjedhur për kontroll, dhe i njëjti pasi është dërguar për kontroll më të detajuar në pjesën e poshtme të tij është gjetur një rezervuar i shtuar metalik, pas hapjes të të cilit janë gjetur gjithsej 30 pako të mbështjella me folie transparente, që përmbanin substanca të dyshuara narkotike të llojit marihuanë. Peshat totale e sasisë së konfiskuar është 32.4 kilogramë. Në përputhje me procedurat ligjore janë konfiskuar dy telefonë celularë dhe automjeti i dyshuar është sekuestruar për hetime të mëtejshme, ndërsa i dyshuari është arrestuar dhe është dërguar në ndalim policor për 48 orë. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për të garantuar sigurinë dhe rendin, duke luftuar me vendosmëri çdo formë të krimit, përfshirë trafikun e narkotikëve dhe veprimtaritë e paligjshme që rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve.



Policia e Kosovës arreston dy të dyshuar për kontrabandim me migrantë, nga të cilët njëri udhëheqës i grupit kriminal



Policia e Kosovës (Sektori i Hetimeve të Departamentit për Kufi), në bashkëpunim me AKI-në, pas disa muajsh monitorim, ka arrestuar më 23 dhjetor 2025 një shtetas jordanez dhe një shtetase turke, të dyshuar për veprën penale “Kontrabandim me migrantë”. Jordanezi dyshohet se ka organizuar hyrjen e migrantëve kryesisht nga Lindja e Mesme dhe Azia në Kosovë, për t’i kontrabanduar më pas drejt vendeve të BE-së, duke udhëhequr një grup të organizuar kriminal që dyshohet të ketë përfituar të ardhura të mëdha. Gjatë kontrollit janë konfiskuar 53 pasaporta të shtetasve jordanezë.

Përgatiti: Arlinda Rexhepi – Gërzhaliu

MUZEU I POLICISË SË KOSOVËS SI OBJEKTIV I RËNDËSISHËM PËR RUAJTJEN DHE PROMOVIMIN E TRASHËGIMISË INSTITUCIONALE



MA Sami Sallahu
Shef i Sektorit të Arkivit Qendror
DPP-Prishtinë

Historia e Policisë së Kosovës paraqet jo vetëm një rrugëtim profesional, por edhe një mozaik sakrificë, përkushtimi dhe vizioni institucional. Çdo uniformë, dokument dhe eksponat bart rrëfimin e atyre që ndërtuan themelet e sigurisë publike të vendit. Ruajtja e kujtesës kolektive është jo vetëm obligim historik, por edhe nderim ndaj heronjve të rënë dhe të gjithë atyre që kontribuan në zhvillimin e institucionit.

Muzeu i Policisë së Kosovës synon të krijojë një hapësirë ku historia takohet me publikun, ku e kaluara ndriçon të ardhmen dhe identiteti institucional prezantohet me profesionalizëm. Ky projekt, i mbështetur nga Drejtori i Përgjithshëm, kolonel Gazmend Hoxha, formalizohet me Vendimin nr. 01/0526 të datës 16 qershor 2025, duke autorizuar një grup punues për hartimin e koncept-dokumentit muzeal. Grupi përbëhet nga përfaqësues të të gjitha departamenteve të Policisë, Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtorisë për Informim e Marrëdhënie me Publikun dhe Arkivit Qendror, duke vepruar në përputhje me ligjet dhe strategjitë institucionale.


Muzeu do të dokumentojë dhe ruajë trashëgiminë policore nga viti 1999 deri më sot, përmes identifikimit, grumbullimit, restaurimit dhe konservimit të materialeve historike si dokumente, fotografi, dosje, hartografi, vendime, uniforma, pajisje operative dhe automjete historike, përfshirë ato të heronjve të rënë në detyrë. Materialet do të shërbejnë për ndërtimin e një kalendari kronologjik dhe databaza digjitale për qasje edukative dhe kërkimore.



Projekti përfshin ndërtimin e një infrastrukture muzeale moderne, me hapësira ekspozuese, teknologji interaktive, galeri multimediale, ambiente restaurimi dhe hapësira për aktivitete shkencore e kulturore. Bashkëpunimi institucional dhe ndërkombëtar do të lehtësojë shkëmbimin e përvojave dhe promovimin profesional të Policisë së Kosovës. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet roli i grave, përfshirjes së komuniteteve etnike dhe diversitetit, duke pasqyruar karakterin gjithëpërfshirës të institucionit.

Organizimi dhe funksionalizimi i muzeut do të integrohet në strukturën institucionale me staf profesional dhe aktivitete të standardizuara muzeale. Përmes ekspozitave tematike, programeve edukative dhe aktiviteteve ndërvepruese, muzeu do të rrisë transparencën dhe ndërgjegjësimin publik për punën e Policisë.

Si përfundim, themelimi i Muzeut të Policisë së Kosovës përfaqëson një hap strategjik në ruajtjen e identitetit institucional dhe forcimin e marrëdhënies me qytetarët. Me infrastrukturë moderne, vizion edukativ dhe qasje bashkëkohore, muzeu do të dokumentojë historinë policore, promovojë vlerat profesionale dhe do të shërbejë si urë lidhëse mes institucionit dhe shoqërisë.



BISEDË ME PSIKOLOGUN

Një bisedë domethënëse me Arton Ademin, psikolog klinik në Drejtorinë e Shërbimeve Shëndetësore në Policinë e Kosovës, përmes së cilës do të njohet më për së afërmi për rolin dhe rëndësinë e trajtimit psikologjik



Në një institucion ku përballja me rrezikun, stresin dhe situatat e jashtëzakonshme është pjesë e përditshmërisë, roli i psikologut është jetik. Psikologu nuk është thjesht një profesionist i shëndetit mendor, ai është një mbështetje e vazhdueshme për zyrtarët policorë, një udhërrëfyes në përballimin e sfidave emocionale dhe një faktor kyç në ruajtjen e efikasitetit dhe humanizmit në shërbim.

- Përshkrimi i detyrës suaj profesionale

Një nga detyrat e psikologut brenda institucionit është që të bëjë ofrimin e shërbimeve psikologjike lidhur me traumat psikologjike për të punësuarit e PK-së, ku asiston në menaxhimin e incidenteve kritike përmes këshillimit dhe përkrahjes psikologjike, gjithashtu ofron shërbime këshillimi dhe përkrahjeje për zyrtarët policorë që ballafaqohen me stresin postraumatik dhe merr pjesë në takime pas incidenteve kritike, si dhe raportin lidhur me të gjitha çështjet e shëndetit mendor të punonjësve të PK-së, bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me institucionet që merren me çështjet e shëndetit mendor për punonjësit e PK-së, bën edhe fushata vetëdijësuese dhe parandaluese për ruajtjen e shëndetit mendor.

- Cilat janë sfidat psikologjike që përballet më së shpeshti personeli në Policinë e Kosovës?

Zyrtarët policorë përballen me një sërë sfidash që ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e tyre mendor si p.sh.: ekspozimi i vazhdueshëm ndaj situatave të rrezikshme dhe të paparashikueshme, traumat nga ngjarjet e dhunshme, aksidente apo humbje njerëzore, presioni institucional dhe pritshmëritë e larta nga publiku dhe hierarkia, vështirësi në ruajtjen e balancës mes jetës profesionale dhe asaj personale, ndjenja e izolimit dhe mungesa e mbështetjes emocionale në situata të caktuara.

- Cilat janë përparësitë, lehtësimet dhe detyrimet e stafit policor kur trajtohen përbrenda nga profesionisti i shëndetit mendor?

Trajtimi nga profesionistët e shëndetit mendor brenda institucionit sjell disa përparësi të rëndësishme si: qasje e drejtpërdrejtë dhe e shpejtë në ndihmë psikologjike në çdo kohë, kuptim më i thellë i natyrës së punës policore që ndihmon në përshtatjen e ndërhyrjeve, mbështetje e vazhdueshme, jo vetëm në raste krize por edhe për zhvillim personal dhe profesional.

- Ju lutem na jepni disa këshilla të përgjithshme e që janë esenciale për të qenë i/e qetë me shëndetin mendor gjatë trajtimit të rasteve të ndryshme në punët policore

Puna policore është ndër profesionet më sfiduese dhe stresuese, ndaj ruajtja e shëndetit mendor është thelbësore për të përballuar presionin dhe për të marrë vendime të drejta në situata të vështira. Ja disa këshilla thelbësore për të ruajtur qetësinë mendore gjatë trajtimit të rasteve të ndryshme:

- Kujdesu për veten çdo ditë,
- Bëj gjumë të mjaftueshëm dhe të rregullt,
- Ushqehu shëndetshëm dhe qëndro i hidratuar,
- Ushtro rregullisht, edhe një ecje e shkurtër ndihmon në uljen e stresit,
- Fol hapur për ndjenjat,
- Mos i mbaj emocionet brenda, ndaj përjetimet me kolegët, miqtë apo një profesionist të shëndetit mendor,
- Përdor mbështetjen që ofrohet nga institucioni (psikologë, këshilltarë, trajnime për menaxhimin e stresit).

Është në rregull të ndihesh i/e lodhur, i/e tronditur apo i/e pasigurt, kjo nuk të bën më pak profesionist. Kërkimi i ndihmës është shenjë force, jo dobësie!

- Porosia/thirrja juaj për zyrtarët policorë dhe administrativë në Polici për të besuar me një profesionist të shëndetit mendor?

Të kërkosh ndihmë nuk është shenjë dobësie, por e pjekurisë dhe e përgjegjësisë. Ju ftoj të shihni psikologun si një partner në ruajtjen e fuqisë suaj mendore. Kujdesi për shëndetin mendor është po aq i rëndësishëm sa përgatitja fizike dhe profesionale. Vetëm një zyrtar i qetë dhe emocionalisht i balancuar mund të ofrojë siguri dhe drejtësi me integritet.

Disa porosi:

- Kujdesi për shëndetin mendor të stafit nuk është luks, është përgjegjësi institucionale.
- Investimi në mirëqenie mendore është investim në siguri, efikasitet dhe humanizëm.
- Krijoni hapësira ku zyrtarët ndihen të dëgjuar, jo të gjykuar.
- Mbështetja psikologjike duhet të jetë pjesë e përditshmërisë, jo vetëm pas krizave.
- Mos prit të ndihesh keq për të kërkuar ndihmë, parandalimi është çelësi.
- Të flasësh me një psikolog është si të pastrosh armën, kujdes për mjetin më të rëndësishëm - mendjen.

Shëndeti mendor nuk është tabu – është pjesë e profesionalizmit

Shpresojmë se kjo bisedë do të jetë efektive dhe do të ndikojë pozitivisht tek të gjithë punonjësit. Ju falënderojmë për kontributin!

Intervistoi: Merita Canolli-Gashi

‘MBROJTËSI’, ASET TRASHËGIMOR I POLICISË SË KOSOVËS

‘Mbrotjtësi’ ka mbajtur gjallë kujtimet dhe ka forcuar lidhjen në mes të Policisë dhe shoqërisë, duke dëshmuar se Policia e Kosovës nuk është thjesht një institucion, por një strehë që qëndron për të ofruar siguri dhe për të ndërtuar paqe

Ky artikull mund të duket i çuditshëm, por është shumë autentik, sepse pikërisht në ‘Mbrotjtës’, do të flasim për vetë ‘Mbrotjtësin’.

Revista policore nuk është emërtuar rastësisht me emrin ‘Mbrotjtësi’, sepse ky emër përfaqëson misionin fisnik dhe human të çdo zyrtari policor në mbrotjtje të jetës, pronës, rendit dhe sigurisë së të gjithë qytetarëve pa dallim. Me kalimin e kohës dhe me procesin e tranzicionit institucional, revista u bart tërësisht nën kompetencat e Drejtorisë për Informim të Policisë së Kosovës, ku vazhdon të botohet edhe sot, duke ruajtur standardin, etikën profesionale, qasjen analitike dhe objektivitetin në pasqyrimin e punës policore.

Për më shumë se dy dekada, ‘Mbrotjtësi’ ka dokumentuar fazat më të rëndësishme të zhvillimit të Policisë së Kosovës, sfidat operative, avancimet profesionale, bashkëpunimin me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe arritjet në fushën e sigurisë publike. Revista ka luajtur rol të rëndësishëm në forcimin e kulturës institucionale, promovimin e vlerave profesionale, përhapjen e informacionit të besueshëm dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet njërive të ndryshme policore. Përmes faqeve të saj janë botuar analiza, studime, shkrime edukative dhe materiale trajnuese, duke kontribuar në konsolidimin e një policie moderne, profesionale dhe në shërbim të qytetarëve.

‘Mbrotjtësi’ ka mbajtur gjallë kujtimet dhe ka forcuar lidhjen mes Policisë dhe shoqërisë, duke treguar se Policia e Kosovës nuk është thjesht një institucion, por një strehë që qëndron për të ofruar siguri dhe për të ndërtuar paqe. Përkundër avancimit të teknologjisë, ‘Mbrotjtësi’ do të vazhdojë të mbetet historia e shkruar e Policisë, një trashëgimi në kohë për shumë gjenerata.

Më poshtë gjeni disa nga revistat ‘Mbrotjtësi’ që nga numrat e parë e deri më sot.

Përgatiti:

Çajup Kajtazi dhe

Arlinda Rexhepi – Gërxhaliu



Numri i parë i revistës zyrtare “Mbrotjtësi” është botuar në prill të vitit 2005, me kërkesë të Kai Vittrup, Komisionerit të atëhershëm të Policisë së UNMIK-ut. Ky botim u konceptua si organ i brendshëm informues dhe profesional policor, i cili botohej në tri gjuhë – shqip, anglisht dhe serbisht – një herë në muaj, duke synuar informimin, edukimin profesional dhe ngritjen e transparencës së punës brenda strukturave policore për të gjithë të punësuarit në Policinë e Kosovës.

Me kalimin e kohës dhe me procesin e tranzicionit institucional, revista “Mbrotjtësi” u bart tërësisht nën kompetencat e Drejtorisë për Informim të Policisë së Kosovës, ku vazhdon të botohet edhe sot, duke ruajtur standardin, etikën profesionale, qasjen analitike dhe objektivitetin në pasqyrimin e punës policore. Ajo ka luajtur rol të rëndësishëm në forcimin e kulturës institucionale, promovimin e vlerave profesionale, përhapjen e informacionit të besueshëm dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet njërive të ndryshme policore.

Përmes faqeve të saj janë dokumentuar fazat më të rëndësishme të zhvillimit të Policisë së Kosovës, sfidat operative, avancimet profesionale, bashkëpunimi me partnerët vendorë e ndërkombëtarë, si dhe arritjet në fushën e sigurisë publike. “Mbrotjtësi” nuk ka qenë vetëm një revistë informuese, por edhe një platformë profesionale ku janë botuar analiza, studime, shkrime edukative dhe materiale trajnuese, duke kontribuar në konsolidimin e një policie moderne, profesionale dhe në shërbim të qytetarëve.



SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS: NDERIMI I HERONJVE DHE FORCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

Ngjarjet e këtij viti dëshmojnë përkushtimin e Sindikatës së Policisë së Kosovës për ruajtjen e kujtesës për heronjtë, forcimin e solidaritetit dhe avancimin e profesionalizmit policor

Sindikata e Policisë së Kosovës vazhdon traditën e përkushtimit të saj për nderimin e 24 zyrtarëve policorë të rënë në kryerje të detyrës, të njohur si “Heronjtë e Kosovës”. Këtë vit, përveç aktiviteteve përkujtimore, Sindikata organizoi një sërë ngjarjesh me karakter sindikal, sportiv dhe ndërkombëtar, duke shënuar një ngjarje të pasur me respekt, solidaritet dhe bashkëpunim profesional. Ngjarjet u zhvilluan në rajonin e Pejës, ku përveç garave sportive, u mbajtën edhe takime me përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë delegacione nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Sllovenia, Lituania dhe Qipro.

Ceremonia e hapjes u shënuar nga fjalët e kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, kryetarit të Sindikatës së Policisë së Kosovës, kryetarit të Komunës së Pejës, si dhe përfaqësuesve të Konfederatës Evropiane të Sindikatave të Policisë (CESP), të cilët theksuan rëndësinë e kujtimit të veprës së heronjve të policisë dhe rolin e tyre si shembull frymëzimi për brezat e ardhshëm. Pjesëmarrësit, përfshirë edhe familjarët e policëve të rënë, u përfshinë në gara sportive që përçuan mesazhe bashkimi, respekti dhe përkujdesjeje të përjetshme për kontributin e dhënë në shërbim të vendit.

Në kuadër të aktiviteteve sindikale të organizuara në shenjë nderimi dhe përkujtimi të zyrtarëve policorë të rënë në kryerje të detyrës, përveç aktiviteteve sportive, Sindikata e Policisë së Kosovës, e shoqëruar nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, si dhe përfaqësuesit e sindikatave mike, realizoi një vizitë në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz. Vizita u bë në shenjë nderimi dhe respekti për familjen heroike Jashari dhe sakrificën e tyre sublime për lirinë e Kosovës. Kujtimi për ta mbetet frymëzim i përjetshëm për të gjithë zyrtarët policorë dhe qytetarët e vendit.



Përveç nderimit të heronjve, aktivitetet e këtij viti shënuan një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar sindikal. Në këtë kontekst, u nënshkruan marrëveshje të rëndësishme bashkëpunimi me Sindikatën e Policisë së Lituanisë (LPPS) dhe Sindikatën e Policisë së Sllovenisë – OPS Podravje, duke vendosur themelet e një partneriteti të qëndrueshëm, të barabartë dhe profesional. Këto marrëveshje synojnë forcimin e solidaritetit ndërkombëtar, shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira, zhvillimin e projekteve të përbashkëta në arsimin, sportin, kulturën dhe mirëqenien sociale, si dhe rritjen e ndërveprimit profesional dhe institucional.

Të gjitha këto aktivitete dëshmojnë përkushtimin e Sindikatës së Policisë së Kosovës për ruajtjen e kujtesës për heronjtë, mbështetjen e familjeve të tyre dhe avancimin e profesionalizmit, dinjitetit dhe solidaritetit sindikal të punonjësve të Policisë. Nëpërmjet këtyre iniciativave, Sindikata afirmohet si një organizatë moderne dhe aktive, e cila vepron në mënyrë të qëndrueshme për të garantuar zhvillimin profesional dhe të drejtën sindikale të punonjësve të Policisë së Kosovës.

Përgatiti: Çajup KAJTAZI

NËN DRITËN E KALTËR - TREGIME TË JETËS POLICORE



Shkruar nga:
MSC SHABAN OSMANOLLAJ

Të jesh në shërbim policor është më shumë se profesion, është thirrje, përgjegjësi dhe sakrificë. Pas çdo uniforme blu që ndriçon në rrugët e qytetit, fshihet një njeri me ndjenja, me zemër dhe me një histori që shpesh mbetet e pathënë. Këto tregime janë pasqyrë e jetës së përditshme të policit: me lodhje e guxim, me buzëqeshje e dhimbje, me vendime të vështira, por gjithmonë me një qëllim të madh: të mbrohet jeta, ligji dhe nderi. Polici është ai që zgjohet kur të tjerët flenë, që qëndron në shi e në diell, që shkon drejt rrezikut për t'ua ofruar sigurinë. Në çdo patrullë, në çdo detyrë, ai mban me vete jo vetëm emblemën e shtetit, por edhe besimin e qytetarëve që e shikojnë si simbol të drejtësisë dhe shpresës.

Disa nga këto rrëfime të shkurtra janë dritare të vogla të shpirtit policor. Ato tregojnë se forca më e madhe nuk qëndron vetëm në armë apo ligj, por në zemrën që vepron me ndershmëri, me dashuri dhe me guxim njerëzor. Në dritën e kaltër që ndriçon natën, çdo zyrtar policor është një rreze shprese për vendin, për familjen dhe për ata që besojnë se drejtësia jeton çdo ditë, në heshtje dhe në përkushtim. Më poshtë do t'ju sjellim disa nga tregimet e përditshmërisë së punës policore.

Detyra që nuk mbaron kurrë!

Ishte fundjavë, rrugët e qytetit bosh. Në patrullën e natës, dy policë ndalën një automjet që ecte pa drita. Në vend të fajtorit, gjetën një njeri të humbur, një plak që kërkonte spitalin për të birin e sëmurë.

Në heshtje, njëri nga policët mori timonin, tjetri e mbajti dorën e plakut. Kur arritën në spital, plaku tha:

“Mendova se më ndaluat, por ju më ndihmuat. Kjo është Policia që dua!”

Në atë moment policët kuptuan se detyra nuk matet me orë, por me zemër.

Nën shiun e patrullës!

Shi, errësirë dhe një thirrje në radio: “Një fëmijë i humbur në lagjen e re!”

Dy orë kërkim, rrugë të mbuluara me ujë, derisa një hije e vogël u shfaq pas një makine të braktisur. Fëmija, i lagur e i dridhur, iu hodh në përqaftim policit.

Nuk pati fjalë, vetëm një ndjenjë e fortë sigurie që s'mund të përshkruhet.

Në kthim, patrulla nuk fliste. Vetëm dritat blu pasqyroheshin në pellgje, si zemra që ndriçon edhe në shi.

Uniforma që flet!

Në mëngjesin e ceremonisë së ngritjes së flamurit, një vajzë e vogël iu afrua policit të rreshtuar.

–“A je ti ai që më ndihmove kur rashë nga biçikleta?”

Ai buzëqeshi, por nuk foli, rregulli nuk e lejonte të dilte nga rreshti.

Vajza u largua, por zëri i saj mbeti:

–“Mami, ai është polici im!”

Në atë moment, kuptoi se uniforma nuk është vetëm simbol, por është kujtim i besimit që mbjell tek njerëzit.

Një fjalë që shpëton!

Në një incident familjar, një grua e frikësuar rrinte në qoshe, ndërsa policët përpiqeshin ta qetësonin burrin e saj. Njëri prej tyre u ul në nivelin e saj, i foli ngadalë dhe me butësi:

–“Tash je e sigurt. Askush s'të prek!”

Ajo nisi të qante, por këtë herë nga lehtësimi.

Në raport, ai shkroi vetëm: “Ndërhyrja verbale u realizua me sukses.”

Por në realitet, ishte ndërhyrje e shpirtit.

Kthimi pas detyrës!

Kur përfundon shërbimi, uniforma hiqet, por përgjegjësia mbetet.

Një oficer kthehej çdo natë në shtëpi në heshtje, që të mos zgjonte fëmijët. Një ditë, vajza e tij e vogël i tha:

–“Babi, edhe unë dua të jem polici i ëndrrave!”

Ai e mori në krahë dhe kuptoi se puna e tij s'ishte vetëm ruajtja e rendit, por edhe ndërtimi i besimit tek brezat që rriten duke parë shembullin e mirë.

Zëri i sirenës!

Në çdo sirenë që dëgjohet në qytet, dikush lutet që ajo të mos ndalet pranë shtëpisë së vet.

Por për policin, sirena është thirrja e jetës, ajo që e zgjon nga gjumi dhe e çon drejt detyrës.

Shpesh, pas asaj zhurme të fortë, fillon një histori që nuk shkruhet kurrë. Aty fillon heroizmi i heshtur, që vetëm ata që e kanë përjetuar e kuptojnë.

Nën dritën e kaltër!

Në fund të çdo dite, drita e kaltër reflekton në asfalt si kujtesë e përhershme se dikush e ruan rendin, ndërsa të tjerët flenë. Janë drita që nuk shuhet as në errësirën më të thellë. Sepse Policia, në thelb, është ndriçim i njerëzisë në shërbim të sigurisë. Si përfundim këto tregime nuk janë vetëm fjalë. Janë kujtime, përvoja dhe ndjenja që bart çdo zyrtar policor në heshtje. Ato flasin për guximin, humanitetin dhe përkushtimin që s'mund të matet me gradë, por me ndërgjegje. Në çdo histori, ka një mësim: Policia është pjesë e jetës sonë, me njerëz që sakrifikojnë çdo ditë për një shoqëri më të sigurt, më të drejtë dhe më humane.

ZYRTARI POLICOR QË SFIDON KUFIJTË, NË SHËRBIM DHE NË VRAPIM

Shembulli i Xhevdet Xhemajlit dëshmon se shërbimi në polici dhe angazhimi sportiv mund të ecin paralelisht, duke frymëzuar komunitetin dhe kolegët njëkohësisht



Xhevdet Xhemajli, nga fshati Izbicë i Skenderajt, është pjesëtar i Policisë së Kosovës që nga viti 2005. Për më shumë se dy dekada në shërbim, ai ka dëshmuar përkushtim të lartë profesional, duke kontribuar në garantimin e rendit dhe sigurisë publike. Por përtej uniformës, Xhemajli njihet edhe për një pasion tjetër të veçantë, vrapimin garues në distanca të gjata.

Angazhimi i tij në atletikë filloi si një hobi, por shpejt u shndërrua në një përkushtim serioz për të sfiduar vetveten. Që nga viti 2017, fillimisht si pjesë e grupit KTRA (Kosova Trail Running Association) dhe më pas në mënyrë individuale, zyrtari Xhemajli ka marrë pjesë në mbi 60 gara zyrtare në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut, duke garuar kryesisht në disiplinat 10 km, 15 km, 21 km (gjysmëmaratonë), si dhe pesë maratona të plota (42.195 km). Ndër garat më të rëndësishme përmendet Maratona Ndërkombëtare e Kopenhagës në maj 2025, ku përfundoi me kohën 4:52:19.

Përveç pjesëmarrjes në gara, që nga viti 2022 ai është edhe bashkëorganizator i ngjarjes sportive “Vrapimi i Marsit – Izbica 147”, një aktivitet përkujtimor në nder të të rënëve të Izbicës, i cili ka mbledhur vrapues nga të gjitha anët për katër edicione me radhë.

Shembulli i Xhevdet Xhemajlit përfaqëson denjësisht një zyrtar policor që, përveç përkushtimit profesional, kultivon vlera të larta fizike dhe shpirtërore. Ai dëshmon se shërbimi në polici dhe angazhimi sportiv mund të ecin paralelisht, duke e frymëzuar komunitetin dhe kolegët në të njëjtën kohë.

Përgatiti: Arlinda Rexhepi – Gërzhaliu




Xhevdet Xhemajli përfaqëson një zyrtar policor që sfidon kufijtë, duke treguar se disiplinë, guxim dhe pasion mund të bashkohen për të lartësuar profesionalizmin dhe forcën e shpirtit.





Aplikacioni "Lajmëro Policinë – i ridizajnuar dhe tani edhe në iOS dhe Android



Tani në Android & iOS



Get it on
Google Play



Download on the
App Store